

K Ë R K E S Ë

GJYKATËS SË RRETHIT TË FIERIT

Kërkuese: Irena Dhimitër Koti, datëlindja 1970, lindur në Mujalli dhe banuese në Mbrostar Ferko të Fierit, e martuar me një fëmijë.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të shtetasit Arben Koti në bazë të neneve 15 e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Arben Koti është bashkëshorti im. Nga martesë ligjore me të kam dhe një fëmijë të quajtur Aristela Koti.

Arbeni ka punuar në peshkim si privat. Më 27.1.1994, ai si zakonisht ka shkuar për peshkim në Seman në vendin që lidh lumin Seman me detin. Ai iku nga shtëpia në mëngjes herët dhe nuk u kthye më. Për këtë unë jam e interesuar me shokët e tij që peshkonin, të cilët më thanë se ai atë ditë ka shkuar me varkë për të peshkuar dhe nuk u kthye më. Që nga ajo kohë nuk kam asnjë njoftim për të. Për gjetjen e tij kanë ardhur edhe polumbarë nga Tirana dhe Vlora, po ata gjetën vetëm varkën ku kishte hipur Arbeni dhe rrjetat e peshkimit. Bashkëngjitur kam edhe provat shkresore.

KËRKUESJA

Irena Koti